



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1087/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.1087/2017 e datës 19.10.2017, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4,200.00 (katërmijëedyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1087/2017 me datë 19.11.2017 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ku ka pretenduar se me datë 18.11.2017 kryetari i subjektit politik NISMA, në Prizren, Zafir Berisha, në ditën e heshtjes zgjedhore, përmes rrjetit social Facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosjes, z. Mytaher Haskuka. Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është shkelur neni 36 par.1 pika b) e LZP.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, subjekti politik LVV thekson se pretendimet e BIRN janë të pa baza për arsye se LVV ka lidhur koalicion në nivel lokal për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Prizrenit me subjektin politik NISMA, andaj LVV konsideron se marrëveshjet politike ndërmjet subjekteve politike, konkretisht ndërmjet LVV dhe NISMA, nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilës do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik LVV, për shkak të publikimit të një foto me një shkrim të caktuar nga anëtar i subjektit politik NISMA pa autorizimin e subjektit politik LVV. Më tej thekson se legjislacioni në fuqi nuk i njeh koalicionet politike mbi të cilën do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit tjetër politik. Andaj ka kërkuar që ankesa e ankuesit të Refuzohet si e pabazuar.

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se Kryetari i subjektit politik NISMA, Zafir Berisha, në Prizren në profilin e tij në facebook, ka shpërndarë një postim në të cilin shihet se ka përmbyjtje të fushatës zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 18.11.2017 në ora 18:00, ku bënë thirrje që të votohet z.Mytaher Haskuka, kandidat për Kryetarë të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik LVV, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Sa i përket pretendimeve të subjektit politik LVV se marrveshjet politike ndërmjet subjekteve politike, konkretisht ndërmjet LVV-së dhe NISMA nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilës do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik LVV, për shkak të publikimit të një foto dhe legjislacioni në fuqi nuk i njeh kolicionet politike mbi të cilën mund ti shqiptohet gjobë subjektit tjetër politik, mirëpo këto pretendime paneli i vlerësoi se nuk qëndrojnë sepse dispozita ligjore e nenit 32.5 *përcakton subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre*. Me këtë rast Paneli konstaton se është fakt notor i publikuar përmes mediave se subjekti politik NISMA mbështet kandidatin e subjektit politik Vetvendosje për kryetar të Komunës së Prizrenit, dhe Zafir Berisha në cilësinë e përkrahësit dhe mbështetësit të kandidatit të LVV-së për kryetar të komunës së Prizrenit gjatë kohëzgjatjes së heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë për kandidatin për Kryetar Komune nga radhët e subjektit politik LVV me të cilën i bëhet thirrje votuesve të votojnë numrin 10, andaj në këtë bazë rrjedh edhe përgjegjësia e subjektit politik të LVV-së.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, duke përdorur edhe fjalorë denigrues ndaj subjektit të atakuar politik.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1087/2017 më datën 21.11.2017



Kryesues i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*